



Funded by  
the European Union



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE  
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES  
www.isp.com.al



CIVIL  
RIGHTS  
DEFENDERS



Zgjedhje Parlamentare 2021

# UNË MARR PJESË!

Zëri im, vota ime vlen.

Periudha e zbatimit të projektit:  
Mars 2020-Mars 2022

Për procesin e Zgjedhjeve Parlamentare 2021, KShH bashkoi forcat me organizatat partnere **Instituti i Studimeve Politike (ISP)** dhe **Civil Rights Defenders (CRD)** në një projekt, i cili synon të fuqizojë qytetarët dhe shoqërinë civile të angazhohet, të promovojë, të advokojë dhe monitorojë proceset demokratike.

## Kjo iniciativë mbështetet në tre shtylla kryesore:

### Ndërgjegjësim

Nëpërmjet aktiviteteve ndërgjegjësuese të ndryshme, së bashku me partnerët, KShH do të nxisë angazhimin e qytetarëve në proceset demokratike, siç janë zgjedhjet. Ata do të fitojnë njohuri praktike dhe aftësi si të ndikojnë në mënyrë strategjike në proceset demokratike, të marrin pjesë në mënyrë efektive në vendimmarrje dhe të promovojnë praktika të mira për rritjen e angazhimit qytetar.

### Mbështetje financiare për OSHC

Kjo nisëm do të ofrojë mbështetje financiare për të paktën 5 projekt-propozime, të cilat do të zbatohen nga organizatat lokale në të gjithë Shqipërinë. KShH do të mbështesë dhe mentorojë këto organizata për të rritur kapacitetet lokale për të marrë pjesë, promovuar dhe ndikuar proceset vendimmarrëse.



### Monitorim

KShH do të vijojë traditën e monitorimit të procesit para-zgjedhor, ditën e zgjedhjeve dhe pas-zgjedhor në 9 qarqe të Shqipërisë. Me 150 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër, KShH do të monitorojë paktën 200 Qendra Votimi dhe 18 Qendra të Numërimit nga vëzhguesit, të cilët do të raportojnë në kohë realë për ecurinë e procesit zgjedhor.





## Qëllimi i aplikacionit është i dyfishtë:

1. Aplikacioni, i cili do të jetë një nga produktet e këtij projekti do të shërbejë si një platformë informuese për qytetarët se si mund të përfshihen në proceset demokratike në nivel lokal dhe kombëtar; cilat janë të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe cilat janë mekanizmat për përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes.
2. Aplikacioni do të shërbejë për mikro-votim dhe anketim të opinionit publik dhe do të krijojë një lidhje të drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe autoriteteve lokale dhe kombëtare.



“Mobile Application” – Një risi e kësaj iniciative për të edukuar dhe angazhuar qytetarët që të marrin pjesë në proceset demokratike.

## Aktivitete të planifikuara

- 9 forume publike në shkollat e mesme dhe universitetet
- 3 policy papers/analiza politikash
- 3 workshop me OSHC lokale
- 5 fokus grupe
- 3 konsultime
- 1 konkurs me ese
- 5 projekt-propozime të mbështetura financiarisht
- 200 Qendra Votimi dhe 18 Qendra të Numërimit të monitoruara
- 150 vëzhgues të procesit zgjedhor

## Ku do të zbatohet ky projekt?

Në 9 qarqe të Shqipërisë:  
Tiranë, Durrës, Kukës, Shkodër, Elbasan, Korçë, Fier, Vlorë dhe Gjirokastra

